

KONTRATE

per krijimin e ndermarjes se perbashket italo-shqiptare
"EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K."

Ndermjet:

Ndermarrjes EUROTEOREMA S.p.A. me seli ne Torino, via
Papacino 2, me kapital shoqeror prej Lira italiane
1.000.000.000 (nje miliard) ne regjistrim e siper prane
Zyres Tregetare te Gjykates se Torinos me Kod Fiskal N.
06494880013, person juridik, qe vepron ne perputhje me
legjislacionin italian, perfaqesuar nga Dr. Ark.
Giovanni Pascale, i paisur me pushtetet e nevojeshme;


dhe

Ndermarrja N.M.N. Peqin, me seli ne Peqin, (Shqiperi) ne
vazhdim e quajtur shkurt "PEQIN" person juridik qe vepron ne
baze te legjislacionit shqiptar, perfaqesuar nga drejtori Z.
Ahmet Ashiku i paisur me pushtetet e nevojshme;

Ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar dhe te Protokollit
Marveshjes te nenshkruar nga perfaqesuesit e paleve te
lartpermendura ne Tirane me date 15.12.1993, palet u muaren
vesht per sa vijon:

Neni 1.

Palet krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te
emertuar EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K.
EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. eshte person juridik shqiptar, dhe
fiton te drejten per te ushtruar veprimtarine e vet nga data
e miratimit te ndermarjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. nga ana
e organeve kompetente shqiptare.



Ndermarrja EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne aktet e krijimit (Kjo kontrate dhe statuti qe i bashkelidhet asaj).

Neni 2

Ndermarrja EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. ka seline ne Peqin (Shqiperi).
Ajo ka te drejten te krijojë edhe gjetke e jashte sntetit, dege, agjensi, perfaqesi, seli sekondare si edhe ti anulloje ato.

Neni 3

Objekti i veprimtarise ekonomike te ndermarjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. do te jete:

- Ushtrimi i ndermarjes ndertuese per llogari te saj, per me teper duke marre nga ente publike, shoqeri dhe private, ndermarje ne koncesione punesh ndertimore, rrugore, hekurudhore, hidraulike, elektrike, elektronike, te ngrohjes, te kondicionimit, te hidrosanitare, te dekoracionit ne pergjithesi, te papershkrueshmerise, te bonifikimit per ndertime urash, tunelesh, vepra me beton arme ne pergjithesi, kanalizime e, keshtu te gjithe ato pune qe te jene te drejtuara dhe te lidhura me ndertimin.
- Sherbime ne sektore ndertimi ne pergjithesi sherbime ne ndermarje, ente publike e private, te trete ne pergjithesi ne sektorin tekniko-prodhues.
- Prodhimi dhe tregtimi si ne Shqiperi ashtu dhe jashte i materialeve dhe paisjeve ndertuese ne pergjithesi, per me teper marrja dhe koncesioni i perfaqesive dhe agjensive ne te njejtin sektor.

- 
- Shfrytëzimi i kaves (zhavorishtës) për inerte, prodhime betoni, elementesh parafabrikate dhe të paratensionuar, konstruksione metalike ose të perziera, tregëtim produkteve.
 - Drejtim shërbimesh publike, si ujësjellës, depuratore (pastrues), shkarkues, varreza etj..
 - Shoqëria do të mundë gjithashtu të blejë si direkt dhe indirekt pjesëmarrje (kuota) në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja, që kanë objekt analog, të afërt ose të lidhur me të sajën.
 - Shoqëria do të mundë edhe të kryejë çfardo lloj veprimesh mobiliare, imobiliare ose financiare që janë funksionalisht të lidhur me arritjen e objektit shoqëror ajo do të mundet kështu:
 - të nënshkruajë çfardo lloj kontrate bankare, kredi për ndërtime dhe hipotekare
 - të japë kredi, të japë garanci reale dhe personale, garanci ose dorezani për llogari e për detyrim të vet dhe të tjerëve;

Neni 4

Përgjegjësia e ortakëve të ndërmarrjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. është e kufizuar sipas kontributit në kapitalin themelor të nënshkruar dhe të dhënë në përputhje me këtë kontratë dhe statutin e ndërmarrjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K..

Ndërmarrja EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. nuk përgjigjet për detyrimet (borxhet) qoftë progresive qoftë të mëpastajme të ortakëve.

Objekti, veprimtaria e ndërmarrjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. si dhe marrëveshjet me persona të tjerë juridik shqiptarë ose të huaj përcaktohen në mënyrë konkrete në statut dhe rregullohen sipas legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

In 76

Neni 5

Kapitali shoqeror i ndermarjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. eshte 171.500.000 Leke (njqindeshtatedhjetenjemilion-epesqindmije Leke) dhe perbehet nga shumat e derdhura nga ortakët ne natyre ose ne te holla.

Kuotat shoqerore te ndara sipas ortakeve jane:

- EUROTEOREMA S.p.A. 70% (shtatedhjete perqind)
- PEQIN 30% (tridhjete perqind)

Kuotat ne para do te depozitohen nga palet kontrtuese ne nje banke shqiptare ku dhe do te hapet llogaria perkatese.

Kapitali shoqeror i nenshkruar nga ortakët do te jete i perbere keshtu:

per sa i perket shoqerise PEQIN nepermjet dorezimit ne natyre te pasurive dhe te drejtave te vleresuara me mirkuptim te perbashket ndermjet paleve (me indeksin 3,8) ne 51.450.000. Leke (pesedhjetenjemilione katerqindepesedhjetemije Leke) si ne inventarin bashkangjitur qe perben pjese integrante e thelbesore te kesaj kontrate.

Per sa i perket shoqerise EUROTEOREMA S.p.A. nepermjet dorezimit ne para te 6.000.000 Leke (gjashtemilion Leke) nepermjet dorezimit ne natyre te pasurive materiale dhe jomateriale (te dorezohen 50% brenda 6-muajve nga krijimi i Shoqerise dhe 50%-et e mbetur brenda 6-muajve qe pasojne sipas kerkeses se Keshillit Administrativ) vleresuar ne mirekuptim te perbashket ne 114.050.000. Leke (njqindekatermbedhjetemilione pesedhjetemije Leke) si ne inventarin bashkangjitur qe perben pjese integrante e thelbesore te kesaj kontrate.

Vleresimi i kontributeve ne natyre kryer siç u tregua me siper me mirkuptim te perbashket ndermjet paleve do te jete perfundimtar.

Palet do te paisen me nje dokument qe verteton kuotat e derdhura.

Ky dokument do te regjistrohët ne regjistrat e EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K..

Neni 6

Nëndermarrja EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. e fillon veprimtarinë e saj në datën e marrjes së autorizimit përkatës nga organet kompetente shtetërore shqiptare sipas kërkesës së paraqitur nga ortakët shqiptarë në përputhje me legjislativën shqiptarë në fuqi.

Neni 7

Në librin e shoqërisë EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. transkriptohen gjeneralitetet e ortakëve dhe kuotat e pjesëmarrjes të nënshkruara e të derdhura.

Kapitali shoqëror do të mund të rritet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe do të jetë e njohur ortakëve e drejta e opcionit mbi rritjen në përparim me kuotat e mbajtura.

Neni 8

Kohegjatja e nëndermarrjes EUROTEOREME-PEQIN SH.P.K. është faktuar për 10-vjet dhe do të mund të zgjatet afatit ose të shpërndahet përpara afatit me vendim të Asamblesë të Jashtëzakonshme.

Neni 9

Të drejtat e paleve kontratuese janë:

- të marrin pjesë në administrimin dhe drejtimin e nëndermarrjes;
 - të marrin pjesë në ndarjen e fitimeve në përparim me kuotat e pjesëmarrjes së tyre dhe në përputhje me rregulloren e statutit;
 - të marrin pjesë në shpërndarjen e aktivitetit që do të rezultojë nga bilanci i likuidimit në rast ndërprerje të veprimtarisë të nëndermarrjes.
- 

Neni 10

Detyrat e paleve kontraktuese jane:

- te derdhin kuotat e kapitalit siq eshte percaktuar ne nenin 5;
- te marrin pjese ne administrimin dhe drejtimin e ndermarjes siq parashikohet ne statut;
- te ruajne sekretin e veprimtarise se ndermarjes.
- te angazhohen per realizimin e objektivave te ndermarjes.
- mardheniet ndermjet punedhenesit (palet) dhe punetoreve rregullohen sipas ligjeve shqiptare ne fuci.

Neni 11

Organet e ndermarjes EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. jane:

- Asamblea e Ortakeve;
- Keshilli Administrativ;
- Keshilli i Revizionit.

Emerimi i organeve dhe funksionimi i tyre percaktohen ne statut

Neni 12


Te gjitha mosmarveshjet qe rrjedhin nga kjo kontrate qe nuk mund te zgjidhen me vullnet te mire do te zgjidhen nga Arbitrazhi Shteteror Shqiptare ose Gjykata e rrethit Tirane (sipas kompetencave) pa mohuar te drejten e kalimit te ceshtjes Arbitrazhit Nderkombetar te Parisit, qe vendos ne perputhje me Rregulloren Arbitrale Nderkombetare.

Neni 13

Te gjitha dispozitat e hollesishme per ndermarrjen EUROTEOREMA-PEQIN SH.P.K. jane percaktuar ne statutin e saj qe bashkelidhet.

Nemi 14

Kjo kontrate u hartua ne gjuhet shqipe dhe italiane nga
due eksemplare secila, duke pasur te dy tekstet vlere
te barabarte.



Per

Secila nga palet do te marre nga nje eksemplar ne
sicelen gjuhe.

Tirane, 03.04.1993

Per EUROTEOREMA SPA

Per PEQIN

EUROTEOREMA S.p.A.
Il Presidente

Prejori Ahmet...

[Signature]